



KUVENDI I SHQIPËRISË

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

Tiranë më, 10.12.2019

Dokument parlamentar

RAPORT PËR

VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 778 DATË 3.12.2019 “PËR PROPOZIMIN KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PËR EMËRIMIN E NJË ANËTARI TË KËSHILLIT DREJTUES TË AUTORITETIT TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE”

- ***Hyrje***

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, në cilësinë e komisionit përgjegjës, shqyrtoi Vendimin e Këshillit të Ministrave “Për propozimin Kuvendit të Republikës së Shqipërisë për emërimin një anëtar i Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare”, në mbledhjen e datës 10 dhjetor 2019.

I pranishëm në mbledhje ishte Z. Tomi Frashëri, i cili është kandidatura e propozuara nga Këshilli i Ministrave për anëtar i Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare.

- ***Baza ligjore***

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 778 dt.3.12.2019 , “Për propozimin Kuvendit të Republikës së Shqipërisë për emërimin një anëtar i Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP)”mbështetet në nenin 114, pika 3, të ligjit Nr.9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

- ***Qëllimi***

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare është organi rregullator në fushën e komunikimeve elektronike dhe të shërbimit postar, i cili mbikëqyr kuadrin rregullator të përcaktuar në ligjin për komunikimet elektronike, nga ligji për shërbimin postar dhe nga politikat e zhvillimit, të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave.

Pas dorëheqjes së një anëtar i caktuar edhe Kryetar, Z. Ilir Zela, në Këshillin Drejtues të AKEP-së është vakant vendi i një anëtar, si dhe duhet caktuar Kryetari i këtij Këshilli Drejtues.

Në bazë të nenit 114 të ligjit nr. 9818 dt. 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar dhe nenit 111 pika 7 të rregullores së Kuvendit, Komisioni mori në shqyrtim kandidaturën e Z. Tomi Frashëri të propozuar nga Këshilli i Ministrave.

Neni 114, pika 4 të ligjit nr.9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, parashikon që: *“Anëtarët e Këshillit Drejtues duhet të jenë specialistë, me arsim të lartë, të kualifikuar, që kanë, të paktën, 10 vjet përvojë pune dhe të jenë përfaqësues nga sektori i komunikimeve elektronike, postar, i ekonomisë dhe i drejtësisë.”*

Sipas CV-së së paraqitur, Z. Frashëri është diplomuar në Drejtësi dhe ka Master në të drejtë publike dhe Master i Shkencave në të drejtë publike të thelluar në Universitetin Paris II – Pantheon – Assas, Francë.

Z.Frashëri ka një eksperiencë pune që plotëson kërkesat e sipërcituara, gjatë së cilës ka kryer detyra të ndryshme si kërkues shkencor pranë Departamentit të së Drejtës Publike në Universitetin Paris II – Pantheon – Assas, Francë, në vitet 2010 – 2014 ka punuar pranë zyrës së Ombudsman në Paris, Francë dhe nga viti 2014 e në vazhdim punon si këshilltar për koordinimin protokollar dhe diplomatik të Kryeministrit. Gjithashtu Z.Frashëri ka një sërë punimesh dhe publikimesh shkencore.

- ***Diskutimi në komision***

Në mbledhje ishte i pranishëm edhe kandidati për anëtar i AKEP-së, Z. Tomi Frashëri, i cili bëri një prezantim të CV-së dhe karrierës së tij, si dhe paraqiti arsyet që e shtynë të kandidojnë për t’u bërë anëtar në Këshillin Drejtues të AKEP-së. Ai iu përgjigj pyetjeve të anëtarëve të komisionit dhe shpalosi vizionin e tij për mbarëvajtjen e veprimtarisë së AKEP-së.

Deputetët u interesuan në lidhje me karrierën e Z. Frashëri, si dhe me qasjen e tij në lidhje me zhvillime të ndryshme në fushën e komunikime elektronike që mbulohen nga AKEP-ja.

- ***Përfundime***

Në përfundim të diskutimeve, komisioni u shpreh se kandidatura e paraqitur nga Këshilli i Ministrave për anëtar të AKEP-së, i plotëson kriteret ligjore për të qënë anëtar i këtij institucioni, dhe i propozon seancës plenare miratimin e saj.